

NJOFTIM
I MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME
Nr. 820, datë 20.1.2017

MBI HYRJEN NË FUQI TË DISA MARRËVESHJEVE NDËRKOMBËTARE

1. Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian mbi procedurat e sigurisë për shkëmbimin dhe mbrojtjen e informacionit të klasifikuar, nënshkruar më 3.3.2016, hyrë në fuqi më 1.9.2016.
2. Marrëveshje ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Shkëmbimin e Informacionit mbi Verifikimin e Terrorizmit, nënshkruar më 14.4.2016, hyrë në fuqi më 14.9.2016.
3. Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shtetit të Kuvajtit për Bashkëpunimin në Fushën e Shëndetësisë, nënshkruar më 19.11.2014, hyrë në fuqi më 17.11.2016.
4. Memorandum bashkëpunimi në fushën e integritetit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Bullgarisë, nënshkruar më 17.5.2016, hyrë në fuqi më 17.11.2016.
5. Protokoll ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe këshillit Federal Zviceran, i cili amendon konventën e datës 12 nëntor 1999, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Konfederatës Zvicerane për shmangien e taksimit të dyfishtë në lidhje me tatimet mbi të ardhurat dhe kapitalin, nënshkruar më 9.9.2015, hyrë në fuqi më 1.12.2016.
6. Marrëveshje ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Çeke për mbrojtjen shoqërore dhe Marrëveshje Administrative për zbatimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Çeke për mbrojtjen shoqërore, nënshkruar më 13.10.2015, hyn në fuqi më 1.12.2017.
7. Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Emirateve të Bashkuara Arabe për nxitjen dhe mbrojtjen e investimeve, nënshkruar më 15.10.2015, hyn në fuqi më 17.2.2017.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM
Gazmend Barbullushi